



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; wwb-site:www.klsh.org.al

Nr. **658** / 8__Prot.

Tiranë, më 26/ 12/ 2019

V E N D I M

Nr. 162, Datë 26. 12. 2019

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN
"LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR
"Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën
01.01.2015 deri më datën 31.08.2019.**

Nga auditimi i ushtruar në "Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër rezultoi që në përgjithësi veprimtaria e këtij institucioni është kryer në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që rregullojnë veprimtarinë e arsimit universitar. Krahas sa më sipër, u konstatuan parregullsi e shkelje në fushën e kontabilitetit e të raportimit financiar dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik si dhe shpenzime pa efektivitet për fondet e buxhetit, *të cilat janë devijime materiale por jo të përhapura dhe nuk kanë cënuar thellësisht funksionimin e këtij sistemi në këtë institucion*, si dhe dobësi e devijime në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi në zbatimin e dispozitave ligjore të fushës së pagave dhe pagesave, *të cilat janë devijime materiale por jo të përhapura dhe nuk kanë cënuar thellësisht funksionimin e këtij sistemi në këtë institucion, dhe prandaj justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar financiar dhe atij të përputhshmërisë.*

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" të ushtruar në "Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër" (USHLG), sipas programit të auditimit nr. 658/1, datë 10.09.2019 për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 31.8.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin (ISSAI 4000¹):

Ne kemi audituar veprimtarinë e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700², dhe ISSAI 4000.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe atij Financiar të KLSH si dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është i pavarur nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe përgjegjësitë etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Menaxhimi i Universitetit është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit dhe pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (kriteret e auditimit financiar) dhe shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe konsistojnë si më poshtë:

I. Nga auditimi financiar: Në mbajtjen e kontabilitetit, pavarësisht punës së bërë, nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë rregullat kontabël, në bazë të parimit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara; rezultojnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në pagesën e kryer për bordin e administrimit në vleftën prej 4,030 mijë lekë dhe parregullsi në pagesat për anëtarët e senatit akademik; parregullsi dhe vonesa të pa justifikuar në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve; mos dokumentim i sipërfaqeve dhe vlerave të tokës truall, që rezultojnë me një vlere prej 149,169 mijë lekë; shpenzime të fondeve pa efektivitet për 15,8 milionë lekë, nuk është aplikuar amortizimi i AAJM për periudhën 2015-2018, etj.

¹ **ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

² **ISSAI 1700**- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Opinion:

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara materiale, por jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar³”

II. Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁴: Institucioni nuk ka përditësuar rregulloren e brendshme me ndryshimet ligjore që ka pësuar legjislacioni mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor; nuk është hartuar dhe miratuar rregullorja financiare e universitetit; konstatohen parregullsi në zbatimin e dispozitave të prokurimit publik, (që nga përlllogaritja e fondit limit deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punimeve e shërbimeve), dobësi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit; pagesa të pa ligjshme të Bordit të Administrimit dhe në konflikt interesi dhe me dëm ekonomik për fondet e universitetit; dobësi në zbatimin e procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme, vonesa në ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm, parregullsi në administrimin e fondeve me financim të huaj, etj.

Opinion:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara materiale, por jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar⁵.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1.-Gjetje nga auditimi:

Nevoja për hartimin e kuadrit nënligjor nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi procedurën e rekrutimit dhe emërimit të audituesve të brendshëm të sektorit publik në Institucionet e Arsimit të Lartë.

³- Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, “Opinionit me rezerve” do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

⁵ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, **Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura, ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.

Nga auditimi rezulton se për një punonjës të sektorit të AB kontratat e punësimit është nënshkruar dhe lidhur nga Bordi i Administrimit dhe në një rast tjetër nga rektori i universitetit. Grupi i auditimit të KLSH nuk e gjen të arsyetuar dhe të bazuar ligjërisht këtë veprim, pasi bazuar në kompetencat e nenit 49, të ligjit nr. 80/2015, Rregulloren e funksionimit të BA (miratuar me vendimin nr.35, datë 15.3.2017) si dhe përcaktimet e nenit 28 “Bordi i administrimit”, të Statutit të USHLG, Bordi i Administrimit nuk ka kompetenca për lidhje të kontratave të punësimit.

Sa më sipër konstatohet se,

✓ Ekziston një vakum ligjor dhe mungesë harmonizimi midis dispozitivit që rregullon funksionimin e auditimit e brendshëm të sektorit publik (Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”) dhe kuadrit rregullativ mbi arsimin e lartë (ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe Udhëzimi i Ministrit të MASR me nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IPAL”).

✓ Mungesa e kuadrit dhe e akteve nënligjore, mosevidentimi i rolit dhe përgjegjësive në Statut dhe Rregulloren e brendshme, në lidhje me kompetencat e qarta të autoritetit vendimmarrës dhe nënshkruar të kontratës së punësimit dhe realizimit të procedurës së rekrutimit të specialistëve të auditimit të brendshëm në universitetet publike dhe institucionet e arsimit të lartë.

✓ Mungesa e një norme udhëzuese nga ana e MFE dhe MASR mbi mënyrën e përcaktimit të pozicionit të NJAB në IAL. autoritetin, përgjegjësinë dhe unifikimin e praktikave të rekrutimit për pozicionin e audituesit të brendshëm mbart risqe që lidhen me përmbushjen e standardeve profesionale të Institutit të Audituesve të Brendshëm të Floridës (IIA) dhe funksionimin e këtyre strukturave.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 136 -161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi:

Të merren masa që strukturat përgjegjëse të Universitetit t’i kërkojnë NJQHKBFP në MFE dhe MASR, përgatitjen dhe miratimin e një udhëzimi që të përcaktojë dhe standardizojë procedurën e emërimit dhe largimit nga detyra të audituesve të brendshëm, në Njësitë e Auditimit të Brendshëm në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik.

Brenda 2 muajsh

2.-Gjetje nga auditimi:

Nevoja për miratimin e Rregullores së Brendshme të Universitetit të Shkodrës, si dhe hartimin e rregullores financiare dhe asaj mbi shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë.

2.1.Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka vijuar të funksionojë me rregulloren e brendshme të miratuar nga Senati Akademik, me vendimin nr.116, datë 18.5.2010, ku përcaktohen dhe trajtohen misioni, qëllimi, përbërja e degëve, veprimtaria, kompetencat, organizimi i sektorëve, bibliotekës, dhe kriteret e rregullat e disiplinës së punës. Kjo rregullore është bazuar në ligjin 9741, datë 21.5.2007, i shfuqizuar. Ndonëse është miratuar Statuti i ri i Universitetit dhe ka pasur ndryshime në strukturë si, krijimi i pozicioneve të reja apo sektorëve të rinj, nga auditimi u konstatua se, këto ndryshime vijnë të mos reflektohen në rregulloren e institucionit.

2.2. Nuk është miratuar nga Bordi i Administrimit rregullorja financiare dhe ajo për shpërndarjen e të ardhurave. *Më konkretisht,*

Në kuadër të funksionimit të Bordit të Administrimit, vërehet se nuk kanë gjetur zbatim detyrimet që burojnë nga përcaktimet e nenit 49, germa “e” dhe “f”, të ligjit nr. 80/2015, në bazë të të cilave, Bordi i Administrimit në institucionin e arsimit të lartë,

e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.108, datë 17.11.2016.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 136 -161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Rekomandimi:

2.1. Institucioni USHLG, në funksion të kryerjes së përgjegjësive ligjore dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të rishikuar dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme të Rektoratit, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në kuadrin ligjor dhe aktet e tjera nënligjore. Përmirësimet e strukturës organike dhe organigramës së funksionimit të institucionit, ti shërbejnë ndihmesës së punonjësve të institucionit që të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre të punësimit.

2.2. Nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të këtij universiteti, miratohet rregullorja financiare dhe rregullorja për shpërndarjen e të ardhurave të institucionit të arsimit të lartë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga përcaktimet e nenit 49, germa “e” dhe “f”, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në RSH”.

Brenda 30 ditëve

C. MASA ORGANIZATIVE:

1.-Gjetje nga auditimi:

Vlerësimi i përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe koordinimit të veprimtarive të dy titullarëve, Titullari Akademik (Rektori) dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor (Administratori) sipas ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe dispozitave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Nga auditimi, me miratimin e ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, konstatohet se, ligji parashikon, ekzistencën e dy titullarëve, *Rektorit* dhe *Administratorit*, të cilët ushtrojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme dhe pa varësi administrative nga njeri tjetri.

Konkretisht, në nenin 39 e vijues, të ligjit në fjalë, përcaktohet qartë se *“Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare”* (pritje përcjellje të delegacioneve, autoriteteve të larta shtetërore, ceremonitë zyrtare etj), sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Gjithashtu në nenin 51, të ligjit organik mbi arsimin e lartë, përcaktohet qartë se *“Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”.*

Nisur nga kjo ndarje me zgjedhjen e rektorit të USH, në fillim të marrjes së detyrës është vërejtur mbivendosje kompetencash, për shkak të interpretimeve të ndryshme të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike mes Rektorit të Universitetit dhe Administratorit, në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor.

Kështu, me anë të shkresës nr.830/2 prot., datë 16.03.2017, Rektori i USH, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku shprehet se në bazë të vendimit të Bordit të Administrimit nr.31, datë 03.03.2017, Rektori do të mbajë dhe pozicionin e nëpunësit autorizues.

Gjithashtu, në cilësinë e Rektorit të USH “Luigj Gurakuqi”, (por jo të titullarit të AK) është realizuar Akt-marrëveshja “Ndërtim Godinë e re fakultetit Ekonomik, Universiteti i Shkodrës”, me shkresë nr.849/1 prot datë 07.03.2017, ku në nenin 1, thuhet se “Objekti i kësaj aktmarrëveshje janë ndryshimet e mëposhtme në preventivin e punimeve dhe për rrjedhojë dhe ë kontratën për ndërtimin e objektit, pakësim në masën prej 24,320,955 lekë nga vlera e kontratës bazë si dhe shtyrja e afatit të realizimit përfundimtar të kontratës deri më 30.04.2017”.

Këto fakte, tregojnë për mospërputhshmëri ligjore të veprimeve të Rektorit dhe Bordit të Administrimit, fakt i cili është korigjuar dhe rregulluar nga Bordi i Administrimit (BA), në bazë të Vendimit nr.52, datë 25.07.2017, duke ia ngarkuar Administratorit të USHLG, pozicionin e nëpunësit autorizues.

Ky standardizim dhe saktësim i roleve, detyrave dhe përgjegjësive është qartësuar në zbatim të bazës ligjore, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në RSH”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MASR nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi:

Nga ana e titullarit Akademik (Rektori) dhe titullarit të Autoritetit Kontraktor (Administratorit), të vazhdohet koordinimi dhe bashkëpunimi, pa mbivendosje kompetencash, në respekt të zbatimit të dispozitave mbi menaxhimin financiar e kontrollit, ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në RSH” dhe ligjit për “Prokurimin publik”, duke bërë përcaktimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të USHLG.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.-Gjetje nga auditimi:

Parregullsi financiare në ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e procedurës së prokurimit “Ndërtim Godinë e re Fakultetit Ekonomik të Universitetit Shkodrës, realizuar në vitin 2011, lidhur me Kontratën e Punës nr. 803/4 prot., datë 29.09.2011.

Nga auditimi e ecurisë së objektit të prokurimit “Ndërtim Godinë e re Fakultetit Ekonomik Universiteti Shkodrës” me fond limit 313,000,000 lekë pa tvsh, realizuar në vitin 2011 rezulton se është lidhur Kontratë nr.803/4 prot datë 29.09.2011 me OE “C..” shpk me vlerë kontratë 304,386,488 lekë pa tvsh dhe 365,263,789.19 lekë me tvsh), e financuar në masën 156,5 milion lekë nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, sipas Vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.4 datë 19.04.2011, “Për shpërndarjen e Fondeve të Zhvillimit të Rajoneve për projektet e arsimit” dhe diferenca nga të ardhurat publike të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Në bazë të kontratës, së mësipërme, detyrimi kontraktor kohor i zbatimit të saj ishte për 2 vjet nga data e fillimit të punimeve (22.11.2011) dhe në fakt është kolauduar më datë 25.05.2017.

Gjatë ecurisë së zbatimit të kontratës është konstatuar se, për shkak të mos planifikimit të drejtë dhe mos menaxhimin e të ardhurave publike të USH, kontrata është realizuar për 6 vjet, d.m.th ***4 vite me vonesë, duke realizuar kohë mbas kohe kontrata-shtesë, me arsyetimin e moslikujdimeve financiare ndaj operatorit ekonomik “C..” shpk.***

Për sa sipër, janë konstatuar këto veprime juridike midis palëve:

-Kontratë Shtesë “Ndërtim Godinë e re fakulteti Ekonomik i Universitetit të Shkodrës” me shkresë nr.803/12 prot datë 22.11.2013 e lidhur midis AK (me përfaqësues ish-rektorin e USH z.A..H..) me operatorin ekonomik “C..” shpk, në thuhet në nenin 1, pikën 1.1 “Objekti shtyrja e

afatit të realizimit të kontratës edhe me 1 vit tjetër nga nënshkrimi i kontratës shtesë deri më 22.11.2014” dhe pikën nr. 1.4 “**Kontraktuesi merr përsipër mosaplikimin e asnjë lloj kamatëvonesë për mosrealizimin në kohë të likuidimit në realizimin e kontratës.**”

- Kontratë Shtesë “Ndërtim Godinë e re fakulteti Ekonomik Universiteti i Shkodrës” me shkresë nr.803/20 prot, datë 20.11.2014 e lidhur midis AK me ish- Rektorin USH z. A..H..me operatorin ekonomik “C..” shpk, në neni 1 pika.1.1 “Objekti shtyrja e afatit të realizimit të kontratës edhe me 1 vit tjetër nga nënshkrimi i kontratës shtesë deri më 22.11.2015” dhe pika 1.4 thuhet se “Kontraktuesi merr përsipër mosaplikimin e asnjë lloj kamatëvonesë për mosrealizimin në kohë të likuidimit në realizimin e kontratës.”

Pra faktet e mësipërme, tregojnë, se palët kanë marrë detyrim kontraktor shtesë, për të mos vendosur kamatëvonesë për realizimin e detyrimeve nga të dyja palët, të cilën e ka prishur operatori ekonomik “C..” shpk, duke depozituar kërkesë padi për aplikimin e kamatëvonesave, të detyrimeve financiare, ku në bazë të Urdhrit të Ekzekutimit nr. 3313 Akti, lëshuar me datë 14.05.2015, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe në bazë të Kodit Civil, neni 589 dhe neni 591 dhe ligjit nr. 48/2014 neni 5, pika 1 si dhe në bazë ligjit nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin Përmbartimor Gjyqësor privat”, **ka përfituar vlerën në total 3,879,444 lekë (interes vonesat, taksa e përmbartuesit gjyqësor privat, pagesa të ekspertit) nga buxheti publik i USH.**

Kështu, sa më sipër, nga ana e USH, për vitin 2015, janë planifikuar 0 lekë për investimin e filluar në vitin 2011 të objektit të prokurimit “Ndërtim Godine e re Fakultetit Ekonomik, Universiteti Shkodrës”. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4, neni 60 (fondin e përlllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare); Udhëzimin e APP nr. 2, datë 27.01.2015 si dhe me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 40 (E drejta për të kryer shpenzime) që shpreh se, “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shume vjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limit të miratuar për angazhime”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr.48, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe Udhëzimin nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” të Ministrisë së Financave.

Për sa më lartë, kjo vlerë prej 3,879,444 lekë paraqitet si efekt financiar negativ për buxhetin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, shkaktuar nga mosplanifikimi i drejtë i shpenzimeve në vendimmarrjet për vitin 2015, sipas vendimit të KAD nr. 69, datë 19/02/2015 për “Për detajimin e buxhetit për vitin 2015”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi:

Nga Autoriteti Kontraktor i Universitetit publik të Shkodrës, të merren masa, që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shume vjeçare, procedurat e prokurimit të planifikohen të kryhen vetëm pasi të jenë siguruar fondet e duhura në buxhetin publik, në mënyrë që objektet të synohet të prokurohen dhe të realizohen në kohë, duke realizuar performancë pozitive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.-Gjetje nga auditimi:

Shkelje dhe parregullsi nga auditimi i procedurave me objekt “Kabina elektrike” viti 2018; “Sisteme ventilimi dhe kondicionimi” viti 2018; “Pajisje laborator, fizioterapi” viti 2018.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme, u konstatua se, hartimi i dokumenteve të tenderit ka mangësi e të meta, e sidomos

A.Në hartimin e specifikimeve teknike të miratuara nga titullari i AK-së, njësia e prokurimit ka vendosur në lidhje me përvojat e ngjashme kriteret 2.3.1.a dhe 2.3.1.b, duke kërkuar:

2.3.1.a) Punë të ngjashme për një kontratë të vetme në një vlerë prej **jo më të vogël se 50% e vlerës së fondit limit** në masën (X duke iu referuar secilit objekt tenderues) të realizuar gjatë tre viteve të fundit,

Ose

2.3.1.b) Punë të ngjashme ku vlera totale e kontratave të punëve të realizuara të marra së bashku gjatë tre viteve të fundit është në vlerën jo më pak se dyfishi i vlerës në masën (x) lekë.

Ndërsa, sipas ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” neni1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” seksioni II (informacione të veçanta për kontratat) neni 26 (Kontratat për punë publike) pika 6, thuhet se :

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është **jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Sipas kësaj dispozite, në prokurimin e kontratave punë publike, për të provuar realizimin me sukses të eksperiencave të ngjashme, sipas bazës ligjore, autoriteti kontraktor duhet t’u kërkojë ofertuesve të plotësojnë njërin prej kushteve të sipërcituara, duke kërkuar **në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës, d.m.th. nga 50% e poshtë, ndërsa AK** kërkon vlera jo më të vogël se 50% , duke eliminuar vlerat që janë më poshtë së 50% e vlerës së kontratës, duke ulur numrin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” neni1, neni 20 dhe 23; me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, seksioni II (informacione të veçanta për kontratat) neni 26 (Kontratat për punë publike), pika 6 dhe për kontratat e mallrave neni 27, pika 3.

B.Në hartimin e specifikimeve teknike të miratuara nga titullari i AK-së, njësia e prokurimit ka vendosur kriteret (2.3.5); (2.3.10);(2.3.11) dhe (2.3.12) të cilat janë publikuar vetëm në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimeve Publike, duke mos argumentuar vendosjen e tyre, nëpërmjet një procesverbali, **ku hartimi i tyre duhej të argumentohej teknikisht dhe ligjorisht, kjo në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 pika 5 (Kontratat për punë publike) dhe neni 7, pika 3.**

C.Në hartimin e specifikimeve teknike të miratuara nga titullari i AK-së, njësia e prokurimit ka vendosur kriterin (2.3.7) “Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë **origjinën e mallit, të gjitha pajisjet dhe materialet duhet të shoqërohen me Certifikatë e origjinës dhe Deklaratën e Konformitetit ,(CE), të cilat do të përdoren për realizimin e objektit tenderues, sipas normave të Bashkimit Evropian ICE”, **duke mos kërkuar në DST, që certifikatat e cilësisë të jenë të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).** Ndonëse nga APP dhe DPA, (si organi i specializuar në këtë fushë me qëllim për të verifikuar nëse, një certifikate e paraqitur në një procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë është lëshuar apo jo nga një organ i vlerësimit të konformitetit dhe nëse, ky organ është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), në kuadër të bashkëpunimit të tyre institucional, është**

lëshuar rekomandimi nr.3330 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”, ky rekomandim nuk ka gjetur zbatim të plotë.

Si pasojë e aplikimit të certifikatave të cilësisë, të panjohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, është shpallur fitues operatori ekonomikë në mënyrë të padrejtë, duke vënë në diskutim cilësinë e procedurave të prokurimeve të financuara nga fondet publike.

Këto veprime, kanë si ardhur si pasojë edhe e faktit se, AK i Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, ka mungesa të theksuara të burimeve njerëzore të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit, ndaj forcimi i kapaciteteve administrative të autoritetit kontraktor, mbetet një nevojë e vazhdueshme, ku në bashkëpunim me APP dhe në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, bëhet domosdoshmëri organizimi i trajnimeve për punonjësit e USHLG të angazhuar me procedurat e prokurimit publik.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Rekomandimi:

3.1.Nga AK i USHLG, të merren masa, për të analizuar të gjitha veprimet nga strukturat prokuruese, me qëllim që vendosja e kriterëve dhe kërkesave kualifikuese , të kryhet në përputhje me bazën ligjore, në mënyrë që fondet publike, të realizohen me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

3.2. Nisur nga fakti se ka mungesa të theksuara të burimeve njerëzore në AK të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të cilët kryejnë detyra në procedurat e prokurimit., lihet detyrë që të rishikohet struktura organike me qëllimin që të forcohen kapacitetet administrative të autoritetit kontraktor, kjo si nevojë e vazhdueshme, dhe në vijimësi në bashkëpunim me APP, të organizohen trajnime për punonjësit e USH të angazhuar me procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. -Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi është konstatuar se, arsyetimi për llogaritjen e sasisë së gazoilit të prokuruar për ngrohje, nuk rezulton e mbështetur në bazë të normativave së harxhimit për orë nga kaldajat. Gjithashtu, dhe sasi të gazoilit për përdorim nga mjetet motorike, nuk rezultojnë të mbështetura në bazë të normës së harxhimit të mjeteve, sipas km të përshkruara dhe vjetërsisë së automjeteve, por është bazuar vetëm në bazë të kërkesave mbi sasi të nevojshme të paraqitura nga Fakultetet e USH “Luigj Gurakuqi”.

Gjithashtu, në procedurën e prokurimit “kërkesë për propozim”, me objekt “Blerje gazoili për ngrohje për kaldajat dhe për automjetet” për vitin 2017, në dokumentet e tenderit të AK, në lidhje me shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pikën 2.3.3 e “Kapacitetit teknik”, u konstatua se,

✓ AK ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin ***dëshmitë përkatëse për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, duke paraqitur fletë analizat për karburantin e kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas standardeve të përcaktuara*** në specifikimet teknike të shoqëruar nga treguesit për normat e parametrat e lejuara teknike dhe mjedisore. AK në dokumentet e tenderit ka përcaktuar se të dhënat teknike të Gazoilit (*diesel 10ppm*) duhet ti referohen *standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar S SH EN 590:2013 +A1:2017.*

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se nga operatori ekonomik “A..T..” sh.a, në dokumentacionin e dorëzuar në AK, për lidhjen e kontratës si operator ekonomik fitues, është paraqitur Raport Analiza, lëshuar nga Inspektorati

Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) datë 28.09.2017, **me standard S SH EN 590:2013 dhe jo S SH EN 590:2013 +A1:2017.**

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, rezulton se **standardi S SH EN 590:2013 është i shfuqizuar** dhe është zëvendësuar me standardin S SH EN 590:2013 +A1:2017.

Pra, ky dokument (raport analize) është në kundërshtim me përcaktimet e AK në dokumentet e tenderit, si rrjedhim KVO, e ka klasifikuar dhe më pas e ka shpallur fitues operatorin ekonomik, në kundërshtim me ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 1/a.

Për sa më sipër, AK duhet ta s’kualifikonte operatorin ekonomik “A..T..” sh.a, për mos plotësim të kriterëve të vendosur dhe miratuar nga autoriteti kontraktor, duke vijuar procedurat dhe shpallur fitues operatorin ekonomik të klasifikuar në vijim dhe me dokumentacion të plotë e të rregullt ligjor, teknik dhe financiar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1.Rekomandimi:

Autoriteti Kontraktor i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të procedurës së prokurimit, “*Blerje gazoil për ngrohje për kaldajë dhe për automjetet*”, për vitin buxhetor 2017, sa trajtuar në Akt konstatimin e KLSH nr.5, duke bashkëpunuar me Agjencinë e Prokurimit Publik, për vlerësimin e shkeljeve në mbështetje të neneve 13 dhe 65, 66 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

5.-Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “***Sisteme ventilimi dhe kondicionimi***”, **viti 2018**, “kërkesë për propozim”, me numër reference të procedurës REF -92341-10-31-2018, u konstatua, se në konkurrim kanë marrë në pjesë 2 (dy) operatorë ekonomik, dhe 1 person fizik, dhe më hollësisht:

- ✓ 1) S.. –K..shpk me Nuis K..., me ofertë ekonomike 1,979,000 lekë pa tvsh dhe 2,374,800 lekë me tvsh, në plotësim të plotë të kriterëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke u shpallur fitues.
- ✓ 2) E... shpk me Nuis J., me ofertë ekonomike 1,960,100 lekë pa tvsh dhe 2,352,120 lekë me tvsh, i cili është s’kualifikuar, pasi nuk ka plotësuar kriteret e paraqitura nga AK, kriterin (2.3.2);(2.3.5);(2.3.9);(2.310);(2.3.11);(2.3.12) dhe (2.3.12).
- ✓ 3) *Personi fizik L..P..* me Nuis K..., me ofertë ekonomike 2,057,000 lekë pa tvsh dhe 2,468,400 lekë me tvsh, u konstatua se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion sipas kriterëve të kërkuar nga AK, por vetëm ekstraktin QKB dhe *formularin e ofertës*.

Nga auditimi, pranë sistemit elektronik app.gov.al dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në AK për lidhjen e kontratës, u konstatua se **personi fizik L..P.., rezulton si punonjëse pranë operatorit ekonomik “S..K..shpk”**, kjo në bazë të formularëve të listë pagesave të periudhës janar-tetor 2018 (formulari e-sig25a, deklaruar në Drejtorinë e Tatimeve, dhe të plotësuara në bazë të VKM nr.514 datë 20.09.2017).

Ky veprim i operatorit ekonomik “S..K.. shpk”, është në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 16 (Deklarimi i konfliktit të interesit dhe informacionit konfidencial) pika 1, ku thuhet se “*Ky deklarami garanton autoritetin kontraktor që ofertuesit /kandidatet nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhëna personale të ofertuesit/ kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt, sipas legjislacionit përkatës në fuqi*” si dhe neni 65 (Ndërhyrja në ofertë) ku përcaktohet se, “Asnjë

ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.”

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1.Rekomandim:

Nga strukturat përgjegjëse të Autoritetit Kontraktor, të analizohen dhe merren masa në vijimësi për shmangien e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit midis operatoreve ekonomikë si ofertues të mallrave dhe shërbimeve dhe për situatat e dyshuara e të konstatuara të raportohet tek Autoriteti i Konkurrencës, i cili duhet të kryejë hetime të mëtejshme për të konstatuar shkeljen e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.-Gjetje nga auditimi:

Mos arkivimi i dosjeve të prokurimit

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurave tenderuese të zhvilluara nga USH, në cilësinë si autoritet kontraktor, për vitet buxhetor 2017 dhe 2018, u konstatua se, plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar rregullisht nga marrësi dhe nga dorëzuesi i tyre në fondin arkivor të institucionit.

Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar, Ligjin nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandimi:

Nga Autoriteti Kontraktor i USHLG, të merren masa, në mënyrë sa më të shpejtë që të bëhet inventarizimi i plotë dhe arkivimi i tyre në përputhje me bazën ligjore respektive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7.-Gjetje nga auditimi:

Mbi respektimin e strukturës organike

Pavarësisht faktit që, janë zhvilluar disa konkurse për rekrutimin dhe plotësimin e pozicioneve të punësimit (2015-2019), rezulton se: Ende në disa fakultete të USH, numri i personelit akademik dhe atij ndihmës nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar, në një trend pothuajse të njëjtë në gjithë periudhën nën auditim.

- ✓ **Për vitin 2015** numri i punonjësve efektivë të miratuar nga BA për USH është 332 gjithsej dhe realizimi 272 punonjës, nga ku 179 prej tyre janë personel akademik, ndërsa 93 janë personel ndihmës akademik me karakter administrativ. Njëkohësisht konstatohet se edhe pse numri i punonjësve akademikë efektivë nuk është realizuar, janë angazhuar në funksion të procesit mësimor 137 pedagogë të jashtëm me kohë të pjesshme. Po i njëjti fenomen konstatohet edhe për vitet në vijim. Më konkretisht,
- ✓ **për vitin 2016** numri i punonjësve gjithsej i miratuar nga Bordi i Administrimit është 344 punonjës gjithsej 344 (me mosrealizim prej 58 punonjësish nga plani i miratuar). Në këtë vit akademik numri i pedagogëve të jashtëm me kohë të pjesshme është 253.
- ✓ **Për vitin 2017** numri total i punonjësve efektiv është 344 (me mosrealizim prej 54 punonjësish nga plani i miratuar) ndërsa nr. i pedagogëve të jashtëm me kohë të pjesshme është 215.

- ✓ **Për vitin 2018** struktura ka po të njëjtët nr në strukturë, 344 gjithsej të miratuar. Nga këta ka mungesë në plotësimin e vendeve vakante për 54 pozicione pune, ndërsa numri i pedagogëve të jashtëm është 212.
- ✓ **Viti 2019**, po ashtu ka 344 punonjës të miratuar sipas vendimeve të BA dhe me një mungesë në kapacitete (me mosrealizim prej 52 punonjësish nga plani i miratuar) si dhe 189 pedagogë të jashtëm, të cilët kanë një rënie krahasuar me vitet e mëparshme.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 21 -29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1. Rekomandimi:

Rektori i Universitetit dhe strukturat e tjera përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të USHLG, në përmbushjen e misionit, arritjen e objektivave, rregullave të organizimit, drejtimit dhe administrimit, të rishikojnë dhe analizojnë strukturën organizative dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet të marrë masa për shpalljen dhe plotësimin e vendeve të lira të punës, në ato profile/ degë ku vendet e punës për staf akademik e ndihmës janë të pa plotësuara, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së zënies e ruajtjes së vendit të punës, ku në nenin 21 përcaktohet se: *“Personeli akademik me kontratë: Për mbarëvajtjen e procesit mësimor këshillat e fakulteteve, me kërkesë të departamenteve, i propozojnë Senatit akademik të miratojë punësimin me kontratë të përkohshme pune (deri në një vit) të personelit akademik pa kualifikimin e kërkuar. Plotësimi i vakancave deri në shpalljen e konkurseve dhe përfundimin e shpalljes së fituesve do përmirësoje edhe zbatimin e buxhetit për strukturën e miratuar po ashtu dhe cilësinë e mësimdhënies në Universitetin e Shkodrës”.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8.-Gjetje nga auditimi:

Në kontabilitet nuk është llogaritur amortizimi AAJM duke denaturuar treguesit e vërtetësisë së të dhënave të bilancit kontabël.

Rezulton se nga ana e Sektorit të Financës / Drejtorisë Ekonomike nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara. *Konkretisht*, nuk është llogaritur amortizimi i AQPT për periudhën tre vjeçare, që përfshin vitet 2015, 2016, dhe 2017, e pasqyruar kjo situatë nga analiza e PF të sipërcituara dhe nga kontrollet mbi formatin nr. 7/b, që shoqëron bilancin kontabël të vitit 2018, ku amortizimi i akumuluar për këtë llogari është regjistruar zero lekë. Si pasojë, për periudhën 1.1.2015 deri më 31.8.2019, vlera e amortizimit për klasën 20 “AQPT” regjistron vetëm përllogaritjet e vitit 2018, ndonëse shumë zëra që formësojnë këtë llogari kanë si origjinë transaksionet e vitit 2011 e në vazhdim.

Rezulton se nga USHLG është kryer regjistrimi i lejes së ndërtimit dhe pajisjeve të dhëna nga Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit (AKTI) si vlerë për tu kontabilizuar në llog. 230 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara”, mirëpor kjo nuk është e bazuar, pasi këto zëra nuk janë pjesë e Manualit të Klasifikimit Ekonomik Kontabël për llogarinë 230.

Auditimi vëren se, regjistrimi i kuotës së lejes së ndërtimit dhe i vleftës së pajisjeve të financuara nga AKTI duhet të klasifikoheshin si shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, ashtu siç janë evidentuar në llogarinë 231 dhe shpenzimet e supervizimit, kolaudimit apo mbikëqyrjes së objekteve.

Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; UMF nr. 14, datë

28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre”, i ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1. Rekomandimi:

Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të Universitetit të Shkodrës, të merren masat që,

1. Te transferohet vlera e AQPT-ve që janë studime të realizuara në funksion të ndërtesave, tek vlera e aktivitetit të trupëzuar afatgjatë dhe pas kapitalizimit të llogaritit amortizimi kontabël.

2. Të merren masat që të bëhen përmirësimet në plotësimin e këtyre pasqyrave financiare/formateve përkatëse, të kryhen sistemimet në kontabilitet dhe të reflektohen korrigjimet e duhura me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2019.

Deri në shkurt të vitit 2020

9.-Gjetje nga auditimi:

Mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës në administrim të USHLG, (zëri “toka, troje e terrene”), ku duhet të ishte pasqyruar vlera prej 149,169,492 lekë, shifër kjo e konsideruar materiale për auditimin në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, nga 888 mijë lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.

Konstatohet se, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve në llogarinë nr.210 si dhe vlera e tyre për USHLG në vitin 2015,2016,2017 dhe 2018 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar vetëm për vlefën 888 mijë lekë, e cila ka të bëjë me një transferim aktivi ndërtesë, ku si përfitues është USHLG. Sipërfaqja totale e tokës që ka USH në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ”Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (*Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 961*), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës trull për qytetin e Shkodrës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet me çmimin prej 12,223 lekë/m².

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9. Rekomandimi:

9.1. Administratori i USHLG të ngrejë një grup pune për identifikuar me planimetri dhe genplane sipërfaqet e tokës trull të këtij Universiteti dhe pas saktësisimit të sipërfaqeve dhe vlerave nga ekspertet e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. Për këtë të informohet Bordi i Administrimit të Universitetit.

9.2. Bordi i Administrimit të analizojë dhe mbikëqyrë në vijimësi rregullshmërinë e procedurave të ndjekura nga ana e komisioneve të evidentimit të tokave e trojeve që do të ngrihen nga Administratori si dhe të miratojë rezultatet e procesit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10.-Gjetje nga auditimi:

Nga ana e USHLG nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast.

USHLG nuk ka regjistruar pronësinë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, sa vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”:

Pronat e Universitetit të Shkodrës në vlerën **544 milionë lekë**, (të tilla sipas pasqyrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2018, për zërin ”ndërtesa”, në vlerën 543 milionë lekë; “rrugë, rrjete e vepra ujore” në vlerën 462 mijë lekë, si dhe zëri “toka, troje e terrene” në vlerën 888 mijë lekë), nuk janë të regjistruara në inventarin e shtetit pranë Zyres Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për to nuk zotërohet certifikatë pronësie.

Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Rekomandimi:

10.1. Administratori i Universitetit, të ngrëjë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

10.2. Të ri aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2018, duke përfshirë dhe AQT që ende nuk janë regjistruar si të tilla (Godina e re e Fakultetit Ekonomik etj.).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11.-Gjetje nga auditimi:

Mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve si dhe mos finalizimi i plotë i procesit të inventarizimit në të gjitha rastet me miratimet e titullarit dhe raportet përmbledhëse.

1. Referencat e vëna në disa nga këto urdhra administrativë mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita të shfuqizuara, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, mirëpo nga analiza e praktikave të mësipërme rezulton se nuk zbatohen siç duhet dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

2. Në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit lëvizja e aktiveve nuk është shoqëruar me dokumentacion të rregullt. *Mungojnë në dosjen e asgjësimit fletëdaljet për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit*, (pasi artikujt e inventarit shkarkohen menjëherë sapo u kalojnë përdoruesve), duke shkelur kërkesat e pikës 34, të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik”, që përcakton se, “Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi”.

3. Për periudhën 2015-2019 procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit, si dhe asgjësimi janë realizuar vetëm dy herë, me zgjatje të pajustificuara. *Konstatohet se ky proces është iniciuar sipas urdhrin të ish-Rektorit Artan Haxhi me nr. 132, datë 14.05.2014 dhe është finalizuar në janar 2017.* Në urdhrin e brendshëm të ish-Kancelarit Artan Kolnikaj me nr. 400, datë 05.10.2016 është vendosur ngritja e grupit të punës “për vlerësimin e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit për vitin 2014” (!)

4. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.

2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.”

si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kapitulli V, Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, Inventarizimi i Aktiveve, pika 74, ku përcaktohet:

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

5. Nuk është kryer për periudhën objekt auditimi, inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti apo në çdo proces të inventarizimit të kryer, në shkëlqje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, “*çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

6. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2015 dhe 2016 nuk është hartuar raporti për inventarizimin e karburantit të USHLG për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues*”. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11. Rekomandimi:

11.1. Nga strukturat përgjegjëse, që menaxhojnë këto aktivitete të administrimit material (Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues), të kryhet një proces i kujdesshëm inventarizimi, shoqëruar gjithashtu me vlerësimin rast pas rasti të aktiveve për t’u nxjerrë jashtë përdorimit si dhe për sistemimin e diferencave. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit.

11.2. Bordi i Administrimit, në përmbushje të përgjegjësisë menaxheriale që rrjedhin nga Statuti i USHLG, të marrë masat për analizimin dhe mbikëqyrjen e plotë të këtij procesi, bazuar në ndjeshmërinë dhe riskun e lartë që kanë aspektet e administrimit material.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.-Gjetje nga auditimi:

Në USHLG nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit të aktiveve materiale.

Nga auditimi konstatohet se nga USHLG janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive materiale. Referuar procedurës dhe procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit nga ana e personave të caktuar nga USH për asgjësimin e këtyre materialeve, nuk janë mbajtur dokumentacionet lidhur me procedurën e kryer nga komisioni i asgjësimit, si për vlerësimin dhe ndarja e materialeve sipas destinacionit të tyre, materiale për ankand ose materialeve që duhet të propozohen, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, si dhe vend ndodhjen e gruposjes së tyre, djegien etj. të shoqëruar me fotot përkatëse, duke mos e faktuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve të asgjësuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve, nuk kanë përpiluar një raport përmbledhës mbi rezultatin e

inventarëve duke krahasuar gjendjen kontabël me atë fizike të raportuar nga komisionet e inventarizimit të aktiveve në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. Rekomandimi:

12.1.- Nga ana e strukturave përgjegjëse të Universitetit të Shkodrës të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, evidentimin e vend ndodhjes dhe groposjes së tyre, djegien, etj., shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar në mënyrë rigorozë procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të materialeve, në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12.2.- Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.-Gjetje nga auditimi:

Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore.

Nga auditimi u konstatua se, rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë praktika pak të zhvilluara në praktikë. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosja e kontroleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e Universitetit. Ndonëse janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, mungon monitorimi i kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e risqeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010 dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 136 -161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13. Rekomandimi:

13.1 Administratori i USHLG të marrë masa që të plotësohet regjistri i riskut me të gjithë degët, sektorët, fakultetet dhe aktivitetet, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

13.2. Njëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, të azhurnojë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut së bashku me planin e veprimit për arritjen e objektivave të

programit, e cila të përditësohet rregullisht (çdo tre vjet), ose kur në mjedisin e institucionit ndodhin ndryshime të rëndësishme

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1.-Gjetje nga auditimi:

Vendimmarrje e pa bazuar ligjërish nga Bordi i Administrimit dhe në kushtet e konfliktit të interesit, duke sjellë dëm ekonomik të arkëtueshëm në shumën 4,030,500 lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik.

- ✓ Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) nr. 41, datë 05.05.2017, është vendosur të shpërblehen për çdo muaj anëtarët e BA me nga **22 mijë lekë** dhe kryetari i BA me **25 mijë lekë**. Ky vendim është bazuar në propozimin e administratorit të Universitetit. Në këtë vendim thuhet se “vendimi i shtrin efektet nga data e konstituimit të tij.” Bazuar në këtë vendim është lëshuar urdhri i Administratores me nr. 170, datë 16.5.2017 per pagesat e BA.
- ✓ Me vendimin e Bordit të Administrimit (BA) nr. 44, datë 02.06.2017, është vendosur ndryshimi i masës së shpërblimit të BA për çdo muaj, ku për anëtarët e BA është caktuar masa e pagesës **35 mijë lekë** dhe kryetari i BA me **40 mijë lekë**. Bazuar në këtë vendim është lëshuar urdhri i Administratores me nr. 193, datë 02.06.2017 për pagesat e BA.

Konstatimi:

i. PAGESA E MËSIPËRME NË SHUMËN PREJ 4,030,500 LEKË ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN NR. 9584, DATE 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe VKM nr. 418, DATE 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, lidhja nr. 1 “Arsimi i Lartë Publik” ku është përcaktuar se, *tarifat e shpërblimit për pjesëmarrje në borde, këshilla, është 8,000 lekë si për kryetarin dhe anëtarët e tjerë të bordit.*

Në pikën nr. 3 të VKM nr. 418/2012, i ndryshuar, përcaktohet që,:

“Emërtesa e çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me përjashtim të rastit kur ligji specifik parashikon ndryshe”.

ii. Miratimi i tarifave të shpërblimit të anëtarëve të tij nga Bordi i Administrimit, është jo vetëm në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.02.2012, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore” lidhja nr. 1, por përbën edhe konflikti i interesit, pasi Bordi i Administrimit nuk ka tagër ligjor të përcaktojë tarifat e shpërblimit për vetveten, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se:

“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga, të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

1.1. Rekomandimi:

Nga USHLG, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **4,030,500 lekë**, ndërsa për anëtarët e jashtëm të Bordit të Administrimit të përlloragiten shumat e përfituara padrejtësisht.

Menjëherë

2.-Gjetje nga auditimi:

Sa paguar padrejtësisht, pa mbështetje ligjore dhe jashtë çdo kriteri, anëtarët e Komisionit të Etikës, në shumën 105 mijë lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik.

Janë paguar padrejtësisht dhe jashtë çdo kriteri dhe pambështetje ligjore, anëtarët e Komisionit të Etikës, në shumën 105 mijë lekë, që konsiderohet shkelje e disiplinës financiare me dëm ekonomik

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

2.1. Rekomandimi:

Nga USHLG, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **105 mijë lekë**, nga personat përfitues.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi:

*Shkelje në përlloragitjen e pagesave për honorare për 16 profesorë, anëtarë të Senatit Akademik të Universitetit, në shumën neto prej **317.311 lekë**.*

Me urdhër shpenzimet e nënshkruara, janë paguar për honorare për 16 profesorë, anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit, qe sipas ri llogaritjes nga grupi i auditimit rezultojnë në shumën neto prej **317.311 lekë**. Llogaritjet e kryera për tatimin mbi të ardhurat janë kryer në kundërshtim me nenin 8, “E ardhura e tatueshme“, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 20.01.2016 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga përlloragitjet rezulton detyrimi për tu kthyer, sa paguar padrejtësisht shuma **317.311 lekë**.

Kjo pagesë është kryer duke aplikuar mbajtjen e tatimit në burim, por llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është kryer në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, në bazë të cilit, “Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës“; nenit 9/1 “Tarifat tatimore”, sipas të cilit, “Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të taten sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 20.01.2016 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar,

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

3.1. Rekomandimi:

Nga USHLG të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **317.311 lekë** nga personat përfitues.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi:

Dëmi i shkaktuar për pagesë penalitetesh / kamatvonesa të vendosura nga ana e OSHEE Shkodër në shumën prej 50,102 lekë, sa ngarkuar padrejtësisht fondeve të Universitetit.

Pagesa e kryer për kamatë energjie elektrike është një kundërvajtje administrative që nuk duhet të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit, por duhet të ishte shlyer nga personat përgjegjës që ndjekin shpenzimet, ose në rast të kundërt nga urdhëruesit/autorizuesit e pagesës. Shuma prej 50,102 lekë është shkelje të disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

4.1. Rekomandimi:

Nga USHLG, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 50.102 lekë, të zhdëmtohet nga personat përgjegjës si vprime në kundërvajtje administrative.

Menjëherë

5.-Gjetje nga auditimi:

Nuk janë kontabilizuar dhe arkëtuar detyrimet e studentëve për tarifën e pa paguar të regjistrimit në universitet.

Sipas përfundimeve të misionit të auditimit MASR me shkresën nr. 9815/5, datë 19.12.2016, rezultojnë tarifa të shkollimit të pa arkëtuara për 102 studentë, me një vlerë prej 4,053,598 lekë, për të cilat, edhe pse është lënë rekomandimi nr.2, ku kërkohet të vendoset sistemi i kontrollit të brendshëm për të realizuar në kohë arkëtimin e tarifë së shkollës nga studentët, rezulton se ky sistem nuk është efektiv, dhe se këto detyrime nuk janë kontabilizuar dhe arkëtuar në vlerën e sipërshënuar.

Nga analiza e kësaj problematike deri në fund të vitit 2018 del se,

Nuk janë regjistruar në kontabilitet në llogarinë e të drejtave për tu arkëtuar në fund të vitit 2018, detyrimet e tarifës së shkollimit për studentët që nuk kanë frekuentuar gjatë çdo viti akademik, që për periudhën 2015-2019 arrijnë në 2173 persona. Gjithashtu, vetëm gjatë vitit 2018 rezultojnë 482 studentë që nuk kanë frekuentuar me një vlerë detyrimi prej 14,536,500 lekë, si dhe 8 studentë që kanë frekuentuar por nuk kanë shlyer detyrimin për tarifën e regjistrimit prej 2,326,000 lekë, vlefata këto që përbëjnë të ardhura të munguara dhe si detyrime të pashlyera, të pa kontabilizuara. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi: Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave dhe nenin 9 të ligjit nr. 9228/2004 i ndryshuar, ku thuhet se, “*Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësive ekonomike*”. Mos evidentimi i saktë i të drejtave të arkëtueshme tregon për denatyrim të treguesve të kontabilitetit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 29-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Rekomandimi:

5.1. Nga ana e strukturave përgjegjëse në Universitet të nxirren përgjegjësitë për veprimet e kryera në kundërshtim me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ku në nenin 9 të ligjit nr. 9228/2004 i ndryshuar thuhet se, “*Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së*

njësive ekonomike” dhe të pasqyrohen në kontabilitet gjithë detyrimet e studenteve duke analizuar gjithë periudhën objekt auditimi dhe të merren masa për të arkëtuar tarifatat ligjore në fuqi.

5.2. Të kontabilizohen dhe arkëtohen detyrimet e pa arkëtuara nga studentët për vitin 2018 prej **2,326 mijë lekë** si dhe të kalojnë në një proces të plotë shqyrtimi nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm të USH të gjithë sistemi i detyrimeve të studentëve për periudhën 2015-2019, sipas një plani tematik të veçantë të angazhimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.-Gjetje nga auditimi:

Veprime në kundërshtim me kriteret e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në kuadër të procedurës me objekt “Ekspedita mësimore 2015 dhe 2016” dhe kryer shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për 11,356,000 lekë pa tvsh lekë.

Nga auditimi, për vitin 2015 dhe 2016, janë realizuar respektivisht, procedura me objekt “Ekspedita mësimore”, përkatësisht për v.2015 me fond limit prej 6,000,000 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate prej 5,990,000 lekë pa tvsh; kurse për vitin 2016, me fond limit prej 5,416,666 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate prej 5,366,146 lekë pa tvsh, u konstatua se,

Për këto dy vite, AK ka përzgjedhur realizimin e shërbimit **jo në bazë të VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” (i ndryshuar)** pika IV dhe VII dhe VKM nr.1101, datë 28.12.2015 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve”, **por në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

Kështu, autoriteti kontraktor i USH’ “Luigj Gurakuqi”, (më konkretisht, njësia e prokurimit), për këtë shërbim, në kërkesat teknike kualifikuese, **nuk ka kërkuar dokumentacionin shoqërues bazë, si listën e studenteve, vendin e akomodimit, dietat, e për pasojë në zbatimin e kontratave, mbi realizimi i pagesave për këtë shërbim, nëpunësi zbatues së bashku me titullarin e AK, ish-Rektorin e USH, nuk kanë kërkuar dokumentacionin e mësipërm.**

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 77, me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36, duke evidentuar **vlerën prej 11,356,000 lekë pa tvsh, të pajustificuara me dokumenta vërtetues.**

Gjithashtu, ndonëse procedurat e mësipërme, janë realizuar sipas, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nga auditimi u konstatuan, mangësi mbi mënyrën e përllogaritjes së hartimit të fondit limit, duke mos rezultuar në bazë të shumatores së tre ofertave, konkretisht:

- ✓ Për vitin 2015, vlera totale e përmbledhëses së pagesave për këtë kategori është në vlerën prej 5,946,666 lekë pa tvsh, ndërsa në urdhrin e prokurimit nr. 1130 prot., datë 17.03.2015, vlera e fondit limit është 6,000,000 lekë pa tvsh, dmth **53,334 lekë pa tvsh më shumë se ofertat e ofruara nga testimit i tregut dhe**

- ✓ Për vitin 2016 vlera totale e përmbledhëses së pagesave për këtë kategori është 5,380,242 lekë pa tvsh, ndërsa në urdhrin e prokurimit nr. 1051 prot., datë 02.3.2016, vlera e fondit limit është 5,416,666 lekë pa tvsh, dmth 36,424 lekë pa tvsh më shumë se ofertat e ofruara nga testimi i tregut.

Këto veprime janë realizuar nga kryetari i degës së blerjeve dhe shërbimeve dhe janë miratuar nga ish-rektori i USH në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII, neni 59, pika 1, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Ndërsa për vitin buxhetor 2017, 2018, ky shërbim është realizuar në bazë të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, VKM nr.307, datë 20.07.1992 “Për tarifatat e transportit të udhëtarëve” i ndryshuar, VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” (i ndryshuar) pika IV dhe VII, si dhe VKM nr.1101 datë 28.12.2015 “Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandim:

Universiteti Shkodër “Luigj Gurakuqi”, të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet, pa ekonomikitet dhe pa efizienz të fondeve buxhetore në vlerën prej 11,356,000 lekë pa tvsh.

Menjëherë

2.-Gjetje nga auditimi:

Shpenzime pa efektivitet në kuadër të auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, në lidhje me ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e procedurës së prokurimit “Ndërtim Godine e re Fakultetit Ekonomik, Universiteti Shkodrës” realizuar në vitin 2011, sipas Kontratës së Punimeve me nr. 803/4 prot., datë 29.09.2011.

Nga auditimi i ecurisë së objektit të prokurimit “Ndërtim Godine e re Fakultetit Ekonomik, Universiteti Shkodrës” me fond limit 313,000,000 lekë pa tvsh, realizuar në vitin 2011, rezulton se nga AK është lidhur Kontratë Pune me nr.803/4 prot datë 29.09.2011 me OE “C..” shpk me vlerë kontratë 304,386,488 lekë pa tvsh. Në bazë të kontratës, së mësipërme, detyrimi kontraktor kohor i zbatimit, sipas DT, grafiku i punimeve ishte për tu përmbushur në afatin kohor prej 2 vitesh nga data e fillimit të punimeve (22.11.2011), por faktikisht kjo punë është mbaruar 4 (katër) vite me vonesë, referuar datë së mbajtjes së aktit të kolaudimit që është më 25.05.2017.

Nga auditimi, i ecurisë së zbatimit të kontratës është konstatuar se, për shkak të mosplanifikimit dhe mos menaxhimit të drejtë të të ardhurave publike të USH, kontrata është realizuar për disa vjet vonesë, në kundërshtim me detyrimin kontraktor, duke realizuar kohë mbas kohe kontrata-shtesë, me arsyetimin e moslikuidimeve financiare ndaj operatorit ekonomik “C..” shpk nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Analizuar sa sipër, janë konstatuar këto veprime juridike midis palëve:

-Kontrata Shtesë “Ndërtim Godinë e re fakulteti Ekonomik Universiteti i Shkodrës” me shkresë nr.803/12 prot datë 22.11.2013 dhe nr.803/20 prot datë 20.11.2014, lidhur midis AK përfaqësuar nga ish-Rektori z. A..H.. me operatorin ekonomik “C..” shpk, ku në nenin 1, pika 1.1 thuhet se, “Objekti shtyrja e afatit të realizimit të kontratës edhe me 1 vit tjetër nga nënshkrimi i kontratës shtesë deri më 22.11.2014/ 22.11.2015” dhe pika 1.4 “Kontraktuesi merr përsipër mos aplikimin e asnjë lloj kamatëvonese për mosrealizimin në kohë të likuidimit në realizimin e kontratës.”

Pra faktet e mësipërme, tregojnë, se **palët kanë marrë detyrim kontraktor shtesë, për të mos vendosur kamatvonesa për realizimin e detyrimeve nga të dyja palët, të cilën e ka prishur operatori ekonomik, kontraktuesi "C.." shpk, duke depozituar kërkesë padi për aplikimin e kamatvonesave**, ku në bazë të Urdhrit të Ekzekutimit nr. 3313 Akti, lëshuar me datë 14.05.2015, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe në bazë të Kodit Civil neni 589 dhe neni 591 dhe ligjit nr. 48/2014 neni 5, pika 1 si dhe ligjit nr. 10031 datë 11.12.2008 "Për shërbimin Përmbartimor Gjyqësor privat", OE privat **ka përfituar vlerën në total 3,879,444 lekë (interesa për vonesat, taksa e përmbartuesit gjyqësor privat, pagesa të ekspertit) nga buxheti publik i USH.**

Nga auditimi, u konstatua se, **USH, për vitin 2015 ka planifikuar 0 lekë për investimin e filluar në vitin 2011 objektit të prokurimit "Ndërtim Godine e re Fakultetit Ekonomik Universiteti Shkodrës", kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"** neni 4, neni 60 (fondin e përllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare), Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 si dhe me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 40 (E drejta për të kryer shpenzime), ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligji nr.48, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"; udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".

Kjo vlerë prej 3,879,444 lekë paraqitet si efekt financiar negativ për buxhetin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shkaktuar nga mosplanifikimi i të shpenzimeve në vendimmarrjet e për vitin 2015, sipas vendimit të KAD nr. 69, datë 19/02/2015 për "Për detajimin e buxhetit për vitin 2015".

(Trajtuar më hollësisht në faqet 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Rekomandim:

2.1.Nga Autoriteti Kontraktor i Universitetit Publik Shkodër, të merren masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet, pa ekonomikitet dhe pa efijencë të fondeve buxhetore në vlerën prej **3,879,444 lekë pa tvsh.**

2.2.Nga ana e USHLG të ndiqen me përparësi proceset gjyqësore në proces, për kthimin e shumave të përfituara padrejtësisht dhe në tejkalim të përcaktimeve të kontratave të nënshkruara, nga operatori ekonomik privat.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi:

Parregullsi në dokumentacionin e zbatimit të punimeve

U audituan aspekte të zbatimit të kontratës me objekt " Ndërtim Godine e re Fakultetit Ekonomik, Universiteti Shkodrës ", realizuar sipas kontratës për punë publike nr. 803/4 prot datë 29.09.2011, të lidhur midis AK Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe operatorit ekonomik "C.." sh.p.k. Procesverbali i fillimit të punimeve janë mbajtur më 22.11.2011. Për shkak të kushteve natyrore gjatë zbatimit të punimeve (shirat dhe përmbytjet në zonën e Shkodrës), shtimit të disa zërave të paparashikuara në projekt, pamundësia financiare nga AK për likuiduar situacionet, është miratuar shtyrje të punimeve dhe njoftimi i përfundimit të punimeve është realizuar më datë 30.04.2017.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen teknike konstatohet se **Kontrata përbëhet prej 11 situacione pjesore progresive, të cilat disa prej tyre nuk janë shoqëruar me libresa masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011** "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe

kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Dosja teknike, u vu pjesërisht në dispozicion grupit të auditimit, ku nuk ishte e plotë, e qartë pasi mungonin një pjesë të librezave të masave, certifikata materiale, teste, azhurnimi faktik, korrespondenca midis palëve etj. Nga verifikimi me sondazhe në objekt të punimeve ndërtimore dhe impianteve mekanike u konstatua pasaktësi në kapitullin e sistemit të furnizimit me ujë.

Zëri nr. 1 "Grupi i furnizimit me ujë sanitar me konvertitor frekuence për kontroll variabël të shpejtësisë ndërmjet 24 HZ dhe max 60HZ, me karakteristikat kryesore (Prurja 15 m³/h dhe Prevalenca 35m k H₂O)", nuk ishte vendosur në objekt nga verifikimi, ndërkohë ishte likuiduar në situacionin përfundimtar në vlerën 510,500 lekë pa TVSH ose 612,600 lekë me TVSH. Në kundërshtimet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. 658/2 datë 13.11.2019, theksohet që zëri i "Grupi i furnizimit me ujë sanitar me konvertitor frekuence për kontroll variabël të shpejtësisë ndërmjet 24 HZ dhe max 60HZ, me karakteristikat ", është realizuar nga sipërmarrësi, pavarësisht që në momentin e verifikimit nga grupi i auditimit nuk ka qenë prezent, për arsye sepse është hequr pasi ka pësuar defekt dhe ndodhet në riparim”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 95-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.- Rekomandimi:

3.1.- Nga Autoriteti Kontraktor të ngrihet një grup teknik i specializuar, për të verifikuar zhvendosjen e pompës së furnizimit me ujë sanitar, me qëllim riparimin e saj. Në përfundim të riparimit të justifikohet vendosja e pompës me dokumentacion justifikues. Në rast se nuk arrihet të montohet sipas afatit të përcaktuar nga AK, të merren masa për zhdëmtim të pompës së ujit sanitar në vlerën 612,600 lekë.

3.2- Grupi teknik të marrë masa që të verifikojë vlerën përfundimtare të objektit, në zërat të cilat nuk janë argumentuar me librezat masash, duke realizuar bilancin total përfundimtar të objektit.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar, në ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kontratat individuale të punës, nenin 16/3 të Rregullores së Degëve, Sektorëve dhe Administratës së rektoratit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, miratuar me Vendimin nr.116, datë 18.05.2010 të Senatit Akademik, ndryshuar me Vendimin nr.130, datë 13.10.2014 si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, referuar përshkrimin të punës dhe detyrave që mbulojnë në strukturat përkatëse, u kërkoj në bazë të kompetencave, Rektori dhe Administratori i Universitetit, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

A. Rektori i Universitetit:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të emërtesës së tij në kuadër të varësisë hierarkike dhe institucionale, referuar pikës 3 të

Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe mangësive dhe shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi:

1. **Z.A.H.**, ish-rektori i Universitetit, aktualisht në marrëdhënie punësimi me këtë Universitet masa i lihet kompetencë rektorit aktual, bazuar në parregullsitë dhe mos ndjekjen e procedurave dhe monitorimin e vijueshëm të kontratës për punë publike nr. 803/4 prot datë 29.09.2011, të lidhur midis AK Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe operatorit ekonomik "C.." sh.p.k, nga ku kanë rezultuar shpenzime pa efektivitet.

B. Administratori i Universitetit:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të emërtesës së tij në kuadër të varësisë hierarkike dhe institucionale, referuar pikës 4 dhe 16, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe mangësive dhe shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga **“Vërejtje me paralajmërim”**, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi:

1. **Znj. S. H.**, me detyrë Kryetare e Degës së Financës.
2. **Znj. L. K.** me detyrë ekonomiste e pagave;

C. Rektori dhe Administratori i Universitetit:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të emërtesës së tij në kuadër të varësisë hierarkike dhe institucionale, bazuar në faktin se këto punonjës janë pjesë e stafit akademik apo në strukturat ndihmës akademike me karakter administrativ, referuar pikave 3, 4 dhe 16, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe mangësive dhe shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga **“Tërheqje vëmendje”** deri në **“Largim nga puna”**, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi:

1. **Z.B.X.**, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
2. **Z.M.L.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
3. **Z.I. H.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
4. **Z.A. F.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
5. **Znj.M. C.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
6. **Z.D.U.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit të rektorit të universitetit me nr. 132, datë 14.5.2014;
7. **Znj.M. K.**, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të inventarizimit të pasurisë, sipas urdhrorit me nr. 254, datë 13.9.2017;

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”**, përkatësisht:

1. Z.A.. K.., me cilësinë e Ish-Kancelarit të Universitetit, bazuar në parregullsitë, mangësitë dhe shkeljet e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

F. MASA ADMINISTRATIVE: MASA QË U REKOMANDOHEN, ORGANEVE / STRUKTURAVE TË CILAT, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI KANË NË KOMPETENCË VENDOSJEN E TYRE:

F.1. Masa administrative të rekomanduara për parregullsi e shkelje në fushën e Prokurimit Publik dhe që duhen ndjekur pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike

Mbështetur në nenet 13, 66/ shkronja “b” dhe 72, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në germën “c” dhe “ç”, të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike dhe në referim të përgjegjësive individuale të konstatuara pasqyruar në Akt Konstatimin nr.4,5,6 dhe 7 të mbajtur gjatë auditimit, (protokolluar në USHLG me datë 31.10.2019), observacioneve të subjektit të audituar, kërkojmë që USHLG ti drejtohet Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), për të vlerësuar shkeljet e konstatuara si dhe në bazë të kompetencave të këtij institucioni, marrjen **e masave disiplinore ose administrative (gjobë nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë)**, në raport me shkeljet e konstatuara.

F.2. Masa administrative të rekomanduara për parregullsi e shkelje në fushën e Prokurimit Publik dhe që duhen ndjekur pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Nga auditimi i procedurës me objekt **“Sisteme ventilimi dhe kondicionimi” viti 2018**, kërkesë për propozim me numër reference të procedurës REF -92341-10-31-2018, u konstatua, se kanë marrë në pjesë 2 (dy) operatorë ekonomik, dhe 1 person fizik, dhe nga auditimi, pranë sistemit të app.gov.al dhe në dokumentacionin e dërguar në AK për lidhjen e kontratës, u konstatua se **personi fizik L..P., rezulton si punonjëse pranë operatorit ekonomik “S.. –K.. shpk”**, kjo në bazë të formularëve të listë pagesave të periudhës janar-tetor 2018 (formulari e-sig25a të deklaruara në Drejtorinë e Tatimeve, Ky veprim i operatorit ekonomik “S.. –K.. shpk”, është në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 16 (Deklarimi i konfliktit të interesit dhe informacionit konfidencial) pika 1, ku thuhet se **“Ky deklaram garanton autoritetin kontraktor që ofertuesit /kandidatet nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhëna personale të ofertuesit/ kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt, sipas legjislacionit përkatës në fuqi”** si dhe neni 65 (Ndërhyrja në ofertë) **“Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në**

çfarëdolloj kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.”

Për sa sipër, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor USHLG ti drejtohet Agjencisë së Prokurimeve Publike, që të rishikojnë pozicionin e personit fizik “L..P..me Nuis K.... në lidhje me operatorin ekonomik “S..- K.. shpk”, nëse kanë konflikt interesi midis tyre, si dhe rasti të raportohet tek Autoriteti i Konkurrencës, i cili duhet të kryejë hetime të mëtejshme për të konstatuar nëse ka shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R